

**L I G J**  
**Nr.7768, datë 9.11.1993**

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË "KONVENTËN  
NDËRKOMBËTARE PËR ZHDUKJEN E TË GJITHA FORMAVE TË  
DALLIMIT RACOR"**

Në mbështetje të nenit 16, pika 5, të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Aderimin e Republikës së Shqipërisë në "Konventën ndërkombëtare për zhdukjen e të gjitha formave të dallimit racor", të adoptuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara me rezolutën e saj nr.2106 (XX), datë 21 dhjetor 1965.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

**Shpallur me dekretin nr.693, datë 15.11.1993 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.**